



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br _____ 21/14 _____

Nr. i fq. / Ër. st _____ - 1 - _____

Data: / Datum _____ 30. 01. 2014 _____

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d" dhe 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, në nenin 41.2 "ç" dhe 92 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË STATUTIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni prej 5 (pesë) anëtarëve për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, në këtë përbërje:

- 1.1. Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit;
- 1.2. Xhevahire Selmani (PDK);
- 1.3. Shkelzen Feka (LDK);
- 1.4. Muharrem Shabani (AAK);
- 1.5. Idriz Muzaqi (Zyra ligjore).

Neni 2

- 2.1. Komisioni si në pikën 1 të këtij vendimi, ka për detyrë të procedon për diskutim publik propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.
- 2.2. Komisioni në fjalë kompensohet për çdo takim pune, deri në finalizimin e punës së tij.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.





REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUSHTRRI

01 Nr. / Br 22/14

Nr. i fq. / Br. sh - 1 -

Data: / Datum 30. 01. 2014

VUSHTRRI - VUSHTRRI



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 51.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe të nenit 54.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.01.2014** mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të KPF-së

Neni 1

Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) i KK-së në Vushtrri, me këtë përbërje:

1. **Shpëtim Zhegrova, kryesuesi i kuvendit dhe i KPF-së;**
2. **Ilmi Azemi, anëtar (PDK);**
3. **Mejreme Ismajli, anëtare (PDK);**
4. **Safet Idrizi, anëtar (PDK);**
5. **Tasim Gubetini, anëtar (PD-AKR);**
6. **Ismet Gashi, anëtar (LDK);**
7. **Shkelzen Feka, anëtar (LDK);**
8. _____, anëtar (AAK);
9. **Mehmet Selaci, anëtar (LVV).**


Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 51.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe të nenit 55.3 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2014 mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete

Neni 1

Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit për Komunitete KK-së në Vushtrri, me këtë përbërje:

1. **Zoran Rakic, anëtar (komuniteti serb);**
2. **Bratislav Kostic, anëtar (komuniteti serb);**
3. **Enver Dubovci, anëtar (komuniteti turk);**
4. **Adem Hoti, anëtar (komuniteti ashkali);**
5. **Aziz Emini, anëtar (komuniteti rom);**
6. **Habib Mustafa, anëtar (PDK);**
7. **Habibe Gërxhaliu, anëtare (PDK);**
8. **Fatime Haziri, anëtare (LDK);**
9. _____, anëtar (AAK).

Neni 2

Mandati i anëtare të Komitetit për Komunitete është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit Komunalë.


Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12 dhe 58 "h" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/1202 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, neni 42.1 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2014, mori këtë:

V E N D I M PËR THEMELIM TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Neni 1

1.1 Me këtë vendim, themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:

- **Bajram Mulaku**, Kryetar i Komunës – Kryesues;
- **Besart Shaqiri**, Komandant i Stacionit Policor – anëtar;
- **Shemsi Rrahimi**, Bashkësia Islame në Vushtrri - anëtar;
- **Simo Cimburovic**, përfaqësues i Kishës Ortodokse Serbe – anëtar;
- **Tomislav Angjelkovic**, përfaqësues i komunitetit serb – anëtar;
- **Tahir Maxhuni**, përfaqësues i komunitetit turk – anëtar;
- **Shyqyri Quni**, përfaqësues i komunitetit ashkali – anëtar;
- **Selatin Emni**, përfaqësues i komunitetit rom – anëtar;
- _____, Kryesues i Komitetit për Komunitete - anëtar;
- **Remzije Zekolli**, Zyrtare për Barazi Gjinore – anëtare;
- **Musaj Tërbunja**, Drejtor i Drejtorisë për Arsimit – anëtar;
- **Bajram Beqiri**, Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit – anëtar;
- **Bajram Kela**, FSK – anëtar;
- **Ismet Saraçi**, anëtar i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi për fshatrat Bivolak Zhilivodë, Gllavatin, Prelluzhë, Stroc, Bequk dhe Mihaliq – anëtar;
- **Fatmir Feka**, kryesues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi për fshatrat: Bajskë, Gojbulë, Sllatinë, Tërllabuq, Karaqë, Begaj, si dhe BL "Kalaja" Vushtrri, anëtar;
- **Behram Rrahmani**, Përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale – anëtar;
- **Tafil Hyseni**, Kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;
- **Ekrem Merovci**, Përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-anëtar;

- **Qëndrim Uka**, Përfaqësues nga OJQ – anëtare;
- **Avni Deliu**, Përfaqësues i mediave lokale – anëtar;
- **Nexhdet Osmani**, Përfaqësues i Komunitetit të Biznesit – anëtar;
- **Isak Hyseni**, Përfaqësues i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara – anëtar.

Neni 2

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe Kryesuesi i KKSB, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do të i ushtrojnë në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MPB-së Nr. 27/12 dhe MAPL-së Nr. 03/12 për themelimin e KKSB-së.

Neni 3

Mandati i KKSB-së është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të kuvendit të komunës.

Neni 4

Anëtarët e KKSB-së, për pjesëmarrje në mbledhje, kompensohen në shumën prej 50 €, dhe vetëm për 6 (gjashtë) mbledhje të mbajtura brenda vitit kalendarik.

Neni 5

Në rast se anëtari/ja i/e KKSB-së nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi, apo për çfarëdo sjellje ose veprim e komprometon funksionimin efektiv të KKSB-së, me propozimin e kryesuesit të KKSB-së Kuvendi i Komunës emëron anëtarin tjetër të këtij këshilli.

Neni 6

Ky vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

 Shpëtim Zhegrova



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br _____ 25/14 _____

Nr. i fq. / Br. st _____ -1- _____

Data: / Datum _____ 30. 01. 2014 _____

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR BARTJEN E MJETEVE TË PASHFRYTËZUARA (TË LIRA) NGA TË HYRAT
VETANAKE NGA VITI 2013 NË VITIN 2014

Neni 1

Me këtë vendim barten mjetet e lira të mbetura nga viti 2013 në vitin 2014 në shumën 417,372.95€. Shpërndarja bëhet në kategoritë ekonomike.

Neni 2

- 2.1. Shuma e mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve (kodi 11), në shumën prej 865.24€;
- 2.2. Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë – mallra dhe shërbime(kodi 130), në shumën 47,849.06€ ;
- 2.3. Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë – subvencione dhe transfere(kodi 200), në shumën prej 3,450.55€ (prej tyre 1.450.55 € barten në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, kurse shuma prej 2.000.00 € barten në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport për OVL-në e UÇK-së);
- 2.4. Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë –shpenzimet kapitale(kodi 300), në shumën 365,208.10€.

Gjithsej 417,372.95€

Neni 3

Mjetet e lira barten sipas nenit 2 dhe tabelës, e cila është shtojcë e këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br _____ 26/14 _____
Nr. i fq. / Br. st _____ - 1 - _____
Data: / Datum _____ 30. 01. 2014 _____
VUSHTRRI - VUÇITRAN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 5 "d" të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenin 12 "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E DREJTORËVE DHE
ZËVENDËS DREJTORËVE NË INSTITUCIONET EDUKATIVO-ARSIMORE DHE
AFTËSUERE

Neni 1

Me këtë vendim formohet komisioni për intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:

1. Musaj Tërbunja, Drejtor i Drejtorisë për Arsim;
2. Izet Miftari, Zyrtar i Drejtorisë për Arsim;
3. _____, Përfaqësues i Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji.

Neni 2

Detyra e komisionit është që të bëjë intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve të cilët aplikojnë për drejtorë dhe zëvendës drejtorë të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 3

Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat aq sa do të jetë edhe mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim dhe komisioni i lartëcekur.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenet 11, 12 dhe 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 "ç" të Statutit të komunës, Rregulloren për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndhimë Momentale Entiteteve Publike dhe jo Publike 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011, si dhe në bazë të kërkesës dt. 29.11.2013 të Priftit të Kishës Ortodokse Serbe "Shën Ilija", Kuvendi i komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2014, mori këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE MATERIALE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR KISHËN ORTODOKSE SERBE "SHËN ILIJA"

Neni 1

Me këtë vendim ndahet shuma prej 840.00 € (tetëqind e dyzet euro) nga buxheti i komunës – fondi për subvencione dhe transfere për mbulimin e shpenzimeve të grumbulluara për pagesën e energjisë elektrike dhe të ujit të Kishës Ortodokse Serbe "Shën Ilija" në Vushtrri.

Neni 2

Mjetet e ndara në shumën e lartëcekur do të paguhen vetëm pas sjelljes (dorëzimit) të dëshmisë për shpenzimet e përmendura në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

